VENDIM
Nr. 56, datë 20.2.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË PERSONIT FIZIK GAZMEND VOGLI, LICENCUAR PËR SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV KLAUDIANA"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:
Endirë Bushati kryetare
Sami Nezaj zëvendëskryetar
Gent Ibrahimi anëtar
Suela Musta anëtar
Zylyftar Bregu anëtar,
mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:
KËRKUES: Subjekti televiziv privat vendor "TV Klaudiana".
OBJEKT: Shqyrtim i kërkesës së subjektit televiziv privat vendor "TV Klaudiana".
BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22 e 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VËREN SE:

KKRT, me vendimin nr. 22/01, datë 23.10.2000, ka licencuar subjektin, person fizik Gazmend Vogli, për televizionin privat vendor "TV Klaudiana". Me vendimet nr. 385, datë 30.11.2005 dhe nr. 66, datë 11.2.2011, KKRT ka rinovuar licencën e këtij subjekti.

Me shkresën e datës 28.1.2013, nr. 163 prot., ky subjekt ka paraqitur pranë KKRT-së njoftimin për disa ndryshime të ndodhura në këtë subjekt, duke kërkuar miratimin e tyre nga ana e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

Më konkretisht, subjekti njofton se në datën 25.2.2011, për shkak të angazhimeve të tij profesionale në institucionet shtetërore, ia ka kaluar të drejtat e licencës së "TV Klaudiana", bashkëshortes së tij.

Subjekti, përveç kërkesës, ka paraqitur edhe dokumentacionin zyrtar që vërteton ndryshimet e kryera. Kështu, subjekti ka paraqitur ekstraktin e regjistrit tregtar të datës 23.1.2013, nga i cili rezulton se në datën 8.2.2011, është regjistruar personi fizik në emër të Edlira Vogli, fusha e veprimtarisë së subjektit është: "Veprimtari radiotelevizioni".

Po ashtu, subjekti ka depozituar kopje të certifikatës së çregjistrimit të subjektit person fizik Gazmend Vogli.

Lidhur me ndryshimet e ndodhura në këtë subjekt, KKRT vëren se, mbështetur në nenin 22 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash.

Në rastin konkret, rezulton se subjekti i pajisur me licencë nga KKRT, ka kaluar të drejtat që burojnë nga licenca në një subjekt tjetër tregtar, i regjistruar në formën e subjektit person fizik Edlira Vogli.

Njoftimi i subjektit është bërë jashtë afatit të parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, sipas të cilit: "I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë, duke dhënë dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë

pas bërjes së këtyre ndryshimeve ...”

KKRT e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e subjektit.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22 e 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti person fizik Gazmend Vogli, licencuar për subjektin televiziv privat vendor “TV Klaudiana”, duke vendosur:

a) T’i heqë subjektit person fizik Gazmend Vogli, licencën me nr. 001/TVL të televizionit privat vendor “TV Klaudiana”;

b) Të kalojë licencën nr. 001/TVL të televizionit privat vendor “TV Klaudiana”, subjektit person fizik Edlira Vogli.

2. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë BUSHATI